



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ - DEGA E GJYKATËS KAÇANIK

Numri i lëndës: 2021:050791

Datë: 22.07.2024

Numri i dokumentit: 05965934

P.nr.78/21

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ-DEGA KAÇANIK, Departamenti I Përgjithshem, Divizioni Penal, gjyqtarja Zajrete Muhaxheri me pjesëmarrjen e sekretares juridike Indira Beqa, në lëndën penale ndaj të pandehurit Xh.H nga fsh. ...-Kaçanik, i akuzuar për veprën penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar 2.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Ferizaj: PP.II.nr.355/21 të dt.19.03.2021 dhe veprën penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar 2.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës PP.II.nr.1803/21 të dt.22.12.2021, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar, më datë 17.07.2024, në prezencë të Prokurorit të Shtetit Sadat Topalli, përfaqësuesit të të dëmtuarës M. Sh dhe të pandehurit me mbrojtësen sipas detyrës zyrtare, av. G. Sh, me dt.22.07.2024 mori, shpalli, dhe të njejtën ditë përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri Xh.H nga fsh...-Kaçanik, i lindur me datë ... nga i ati A... e ëma L..., e gjinisë G..., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës. I pa martuar, ka të kryer shkollën fillore, I pa punë, i gjendjes së dobët ekonomike, me numër personal:

ËSHTË FAJTOR

I. Sepse me datë 04.03.2021, rreth orës 09:41 min, në rrugën “Ismail Raka”, Kaçanik, saktësisht në Xhaminë e Qytetit “...”, i pandehuri me qëllim të përvetësimit të kundërligjshëm të pasurisë për vete, nga ndërtesa fetare merr një sasi të parave që ishin grumbulluar për mirëmbajtjen e xhamisë, ashtu që i pandehuri kishte shfrytëzuar situatën kur nuk ishte askush brenda, hyn në xhami vëzhgon se a ka ndonjë person, hap zinxhirin e palltos dhe nxjerr një kaçavidë dhe duke përdorur forcën i thyen dy drynat e arkës, hap arkën dhe merr të gjitha paratë e grumbulluara, të cilat i fut në xhepin e pantallonave ndërsa drynat i fut brenda në arkë.

Me këtë veprim i pandehuri ka kryer veprën penale Vjedhja e rëndë nga neni 315 par. 2 nënpar 2.2 të KPRK-së

II. Sepse me datë 25.10.2021, rreth orës 08:18min, në xhaminë “...” në Kaçanik, i pandehuri me qëllim të përfitimit të dobisë pasurore të kundërligjshme për vete apo tjetrin, duke vepruar në atë mënyrë që ka depërtuar brenda në xhami, ashtu që me përdorimin e forcës ka përdorur mjetin “kaçavidë”, me të cilin ka eliminuar pengesat, duke thyer dryrin e arkës, e cila ishte vendosur për grumbullimin e të hollave për nevoja të xhamisë dhe nga aty kishte vjedhur shumën e të hollave prej 100 (njëqind eurove) €,-

Me këtë veprim, i pandehuri ka kryer veprën penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par 2 nën par. 2.2 të KPRK-së.

Prandaj gjykata, në bazë të nenit 2,7,38,48,69,70, 71 par.1 nënpar.1.3 të KPRK-së, dhe nenit 358,359,360 dhe 364 të KPP-së, e

G J Y K O N

Për veprën penale si në pikën I të dispozitivit, me dënim me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqind euro) dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Për veprën penale si në pikën II të dispozitivit, me dënim me gjobë në shumë prej 200.00 € (dyqind euro) dhe me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.

Konfor nenit 76 par.1 dhe 2 nënpar. 2.2 dhe 2.4 të KPRK-së, të pandehurit i shqiptohet dënim unik me gjobë në shumë prej 400.00 (katërqind euro) dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej 1 (një) viti e 8 (tetë) muaj, të cilat dënime nuk do të ekzekutohen në qofte se i pandehuri brenda 2 viteve nga dita e plotëfuqishmerisë së këtij aktgjykimi nuk kryen ndonjë vepër tjetër penale, në të kundërtën dënimi me kusht do të revokohet.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës, Xhamisë “...” në Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohet në kontest civil.

I pandehuri lirohet nga shpenzimet procedurale, paushallit gjyqësor dhe Fondit për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Konfor nenit 514 par.3 dhe nenit 515 të KPP-se, lidhur me nenin 86 par.1 nënpar.1.2 të KPRK-se, gjykata i shqipton te pandehurit, edhe **MASËN E TRAJTIMIT TË DETYRUESHËM PSIKATRIK NË LIRI.**

Masa e shqiptuar do të ekzekutohet nga Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj, në kohëzgjatje prej 2(dy) vite, nga dita e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, dhe në këtë masë do të përfshihet trajtimi medikamentoz dhe rehabilitimi psikosocial deri në përmirësimin e tij.

Obligohet Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj, që për çdo tre muaj t'i dërgojë raport me shkrim gjykatës lidhur me trajtimin e të pandehurit.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Ferizaj me aktakuzen PP.II.nr.355/21 të dt.19.03.2021 dhe aktakuzën PP.II.nr.1803/21 të dt.22.12.2021 të pandehurin Xh.H nga fsh,Biqec- Kaçanik, e ka akuzuar për dy vepra penale veq e veq, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par 2 nën par. 2.2 të KPRK-së.

Në bazë të kesaj aktakuze, gjykata ka caktuar dhe mbajtur shqyrtimin fillestar, me dt. 17.07.2024.

Konform nenit 34 paragrafi 1 të KPP-së, me aktvendimin të posaqëm të dt.17.07.2024, gjykata ka bërë bashkimin e lëndëve të evidentuara si : P.nr.78/21 dhe P.nr.347/21 dhe ka vendosur që procedura të udhëhiqet sipas lëndës me numër P.nr.78/21.

Prokurori I shtetit Sadat Topalli në fjalën e tij, me rastin e prezentimit te aktakuzave, deklaroi se mbetet ne tërësi pranë aktakuzave të parashtruara me shkrim pranë kësaj gjykate.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, M.Sh., në fjalën e tij I bashkangjitet ndjekjes penale dhe parashtron kërkesë pasurore juridike, në vlerën si në aktakuzë.

I pandehuri ne fjalën e tij në seancën e shqyrtimit fillestar deklaroi se, e pranon fajësinë për veprat penale për të cilat e ngarkon akuza, duke shtuar se këto veprime I kishte ndërmarrë meqë nuk kishte patur ushqim për vete, megjithate e ka kuptuar që kjo ka qenë gabim dhe e ka kuptuar se në rastet e tilla mund t'I drejtohet organve tjera kompetente, dhe jo të thyej arkën e xhamisë dhe t'I merr paratë e grumbulluara, prandaj duke shprehur pendesë për veprimet e tij, njëherit I kërkon gjykatës që me rastin e marrjes së vendimit, t'I shqiptohet një denim sa më I ulët që të jetë e mundur.

Prokurori I shtetit në fjalën e tij është dakorduar me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, duke vlerësuar se pranimi I fajësisë është bërë vullnetarisht, duke kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajësisë dhe në përputhje të plotë me dispozitat e nenit 242 të KPP-së, andaj edhe I propozon gjykatës që të pranohet pranimi I fajësisë për të pandehurin dhe t'I shqiptohet sanksion penal sipas ligjit, duke përfshirë edhe masën për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri, të rekomanduar nga Instituti I Psikiatrisë Forenzike, përmes raportit të dt.29.02.2024.

Mbrojtësja e të pandehurit, av.G.Sh, në fjalën e saj poashtu pajtohet me pranimin e fajësisë nga I mbrojturi I saj, pasi që vlerësoi se pranimi I fajësisë është bërë konfor nenit 242 të KPP-së, dhe poashtu e mbështet edhe propozimin e prokurorit të shtetit për shqiptimin e masës për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri, të rekomanduar nga Instituti I Psikiatrisë Forenzike, përmes raportit të dt.29.02.2024. Mbrojtësja, poashtu I kërkon gjykatës që, duke patur parasysht të lartëcekurat, me rastin e caktimit të dënimit t'I shqiptohet një denim I cili në rastin e të mbrojturit

të saj do të arrinte efektin dhe qëllimin dhe poashtu do të kishte efekt në parandalimin e përgjithshëm të këtyre veprimeve. Fjalën e mbrojtëses, e ka mbështetur edhe I pandehuri.

Gjykata ka konstatuar se janë përmbushur kushtet nga neni 242 par. 1 të KPRK-së, pasi që formoi bindjen se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajesisë, se pranimi i fajesisë është bërë vullnetarisht, se pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes që përmban akuza, se akti akuzues nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore apo gabime teknike, andaj me këtë gjykata vertetoi gjendjen faktike si në dispozitivin e aktakuzës.

Nisur nga kjo gjendje e vërtetuar në procedurë, gjykata gjeti se në veprimet e të pandehurit manifestohen të gjitha tiparet e dy veprave penale, veq e veq, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par 2 nën par. 2.2 të KPRK-së.

Me rastin e matjes dhe caktimit të dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese konform nenit 70 të KPRK-së, kështu që si rrethanë lehtësuese gjykata mori faktin se i pandehuri e ka pranuar fajësinë për veprat penale për të cilat e ngarkon aktakuza në tërësi në shqyrtimin fillestar, duke shprehur pendesë dhe duke i premtuar gjykatës se në të ardhmen nuk do të përsërisë veprime të tilla, faktin se, bazuar në raportin e Institutit të Psikiatrisë Forenzike, në kohën e kryerjes së veprës penale, aftësia e tij mendore për të kuptuar rëndësinë e veprës si dhe kontrolli ndaj veprimeve të tij, ka qenë e zvogëluar në shkallë esenciale, si dhe faktin se, pas kryerjes së këtyre veprave penale, edhe pse kanë kaluar më shumë se tri vite, i njëjti nuk ka përsëritur veprime të tilla, ndërsa rrethanë të posaçme rënduese gjykata gjeti faktin se i njëjti në periudhën kohore të njëjtë gjegjësisht me dt.28.12.2020 dhe 03.09.2021 kishte kryer veprime të njëjta, për të cilat është gjykuar me aktgjykim të formës së prerë të kësaj gjykate me nr.P.nr.43/21 të dt.18.09.2023.

Andaj gjykata, për këto arsye, të pandehurin Xh.H, i akuzuar për veprat penale, Vjedhja e rëndë nga neni 315 par 2 nën par. 2.2 të KPRK-së, e gjykoi me dënim si në dispozitiv, duke vlerësuar se dënimi i caktuar është në proporcion me veprën si dhe sjelljen e të pandehurit, dhe se dënimi i shqiptuar është adekuat me intensitetin e rrezikimit të vlerave të mbrojtura, personalitetin e të pandehurit, andaj edhe konsideron se ky dënim do të ndikojë pozitivisht tek i pandehuri dhe personat tjerë që të mos kryejnë vepra të tilla penale dhe se me këtë do të arrihet në tërësi qëllimi i dënimit i paraparë në nenin 38 të KPRK-së.

Vendimi për shqiptimin e Masës për trajtimin e detyrueshëm psikiatrik në liri, u mor konfor nenit 514 par.3 dhe nenit 515 të KPP-se, lidhur me nenin 86 par.1 nenpar.1.2 të KPRK-së, pasi që gjykata vlerësoi se përmes kësaj mase do të bëhet rehabilitimi i të pandehurit dhe parandalimi që në të ardhmen i njëjti të përsërisë vepra penale.

Masa e shqiptuar do të ekzekutohet nga Qendra e Shëndetit Mendor në Ferizaj, ku përfshihet trajtimi medikamentoz dhe rehabilitimi psikosocial deri në përmirësimin e tij, dhe gjithashtu obligohet, që për çdo tre muaj t'i dërgojë raport me shkrim gjykatës lidhur me trajtimin e të pandehurit.

Vendimi për lirimin e të pandehurit nga pagesa e shpenzimeve procedurale, u mor konform nenit 452 paragrafi 4 të KPP-ës, pasi që Gjykata vlerësoi se pagesa e tyre, bazuar në rrethanat familjare dhe gjendjen ekonomike të të pandehurit, do të rrezikonte gjendjen materiale të tij.

Përfaqësuesi I të dëmtuarës, Xhamisë së qytetit "... në Kaçanik, për realizimin e kërkesës pasurore juridike, udhëzohet në contest civil.

Nga të cekurat e mësipërme u vendos si në dispozitivin e këtij aktgjykimi

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

DEGA KAÇANIK

P.nr.78/21 datë 22.07.2024

Sekretarja Juridike

Indira Beqa

Gjyqtarja,

Zajrete Muhaxheri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mundet të ushtrohet ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.